

VENDIM
Nr. 26/2025

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR “PËR TË KOORDINUAR DHE MBIKËQYRUR TË GJITHA
VEPRIMET INSTITUCIONALE PËR TË LUFTUAR DEZINFORMIMIN DHE
FORMAT E TJERA TË NDËRHYRJES SË HUAJ NË PROCESET DEMOKRATIKE
TË VENDIT”**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit” zgjatet deri në përfundim të Legjislaturës X.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miratuar në datën 13.3.2025.